

University for Business and Technology in Kosovo

## UBT Knowledge Center

---

Theses and Dissertations

Student Work

---

Winter 2-2010

### Parimi "Uti Posidetis" dhe Vetëvendosja në Kontekst të rastit të Kosovës

Isah Mustafa

*University for Business and Technology - UBT*

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Law Commons](#)

---

#### Recommended Citation

Mustafa, Isah, "Parimi "Uti Posidetis" dhe Vetëvendosja në Kontekst të rastit të Kosovës" (2010). *Theses and Dissertations*. 406.

<https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd/406>

This Thesis is brought to you for free and open access by the Student Work at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in Theses and Dissertations by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact [knowledge.center@ubt-uni.net](mailto:knowledge.center@ubt-uni.net).



Faculty of Law, Political Science and Diplomacy

Bachelor Thesis  
Academic Year 2009 - 2010

Student: Isah Mustafa

**Parimi “Uti Posidetis” dhe Vetëvendosja në Kontekst të rastit të Kosovës**

Supervisor: Prof.dr.iur. Eqrem Zenelaj

Shkurt/2010

This thesis is submitted in partial fulfillment of the requirements for a  
Bachelor Degree

# **PËRMBAJTJA**

<b>HYRJE</b> .....	<b>3</b>
--------------------	----------

## **KAPITULLI I**

<b>I/1.RILINDJA SHQIPTARE DHE ZHVILLIMI I VETËDIJES KOMBËTARE PËR VETËVENDOSJE</b> .....	<b>6</b>
--	----------

<b>I/2.Coptimi i trojeve shqiptare, mobilizimi për bashkim dhe vetëvendosje</b> .....	<b>8</b>
---	----------

<b>I/3.Lufta për Vetëvendosje</b> .....	<b>20</b>
---	-----------

## **KAPITULLI II**

<b>II/1.VETËVENDOSJA NË PËRGJITHËSI DHE RASTI I KOSOVËS NË VEQANTI</b> .....	<b>23</b>
--	-----------

## **KAPITULLI III**

<b>III/1.SHPËRBËRJA E ISH-JUGOSLLAVIS DHE GJENDJA JURIDIKO-KUSHTETUESE E KOSOVËS</b> .....	<b>25</b>
--	-----------

## **KAPITULLI IV**

<b>IV/1.PARIMI “UTI POSIDETIS” DHE KOSOVA</b> .....	<b>28</b>
---	-----------

## **KAPITULLI V**

<b>V/1.VETËVENDOSJA DHE QËSHTJA E SHKËPUTJES (SECESIONIT)</b> .....	<b>31</b>
---	-----------

<b>KONKLUZIONI</b> .....	<b>34</b>
--------------------------	-----------

<b>LITERATURA E KONSULTUAR</b> .....	<b>36</b>
--------------------------------------	-----------

## **HYRJJE**

Në këtë punim do të shtjellojm parimin “UTI POSIDETIS” dhe vetëvendosjen, duke ju referuar rastit të Kosovës, si dhe duke bërë një krahasim të këtij parimi, që është prej më të rëndësishmëve në të drejtën ndërkombëtare publike, por edhe për faktin se edhe rasti i Kosovës është ndër rastet më interesante për tu studiuar si në aspektin e vetëvendosjes, po ashtu edhe në aspektin e referimit të parimit “UTI POSIDETIS”.

Punimi që po paraqes është një kontribut i vogël, duke pas parasysh rëndësin e temës, që është komplekse dhe është temë diskutimi nga autor të ndryshëm, vendor e ndërkombëtar, por edhe duke pretenduar se do të arrijë të paraqes në mënyrë të drejt dhe reale rastin e Kosovës në aspekt të vetëvendosjes, duke ju referuar parimit të njohur “UTI POSIDETIS”.

E drejta për vetëvendosje, gjatë zhvillimeve historike ka qenë objekt i paqartësive, mosmarrëveshjeve dhe në raste të ndryshme aplikime kontradiktore. Ky koncept, gjatë viteve është ridefinuar, riaplikuar në bazë të interesave nga shtete të caktuara. Shkatërrimi i BRSS-së dhe Jugosllavis, i ka dhënë një përceptim tjetër kuptimit të vetëvendosjes. Në periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore, një interes shumë më i madh është duke i kushtuar zbatimit të të drejtave të njeriut dhe sëbashku me të edhe ndaj kuptimit të konceptit të vetëvendosjes së brendshme dhe të jashtme.

Qëllimi i këtij punimi është zbatimi i këtij kuptimi të ri të vetëvendosjes në raport me vullnetin e shqiptarëve në Kosovë. Ky fillon me themelimin e lindjes së qështjes së Kosovës para Luftës së Parë Botërore në Ballkan, periudhë kjo e Rilindjes Kombëtare Shqiptare në prag të shkatërrimit të Perandoris Osmane. Në këtë kohë prijësit e shquar shqiptarë kishin përgatitur një program për ruajtjen e identitetit shqiptarë me qëllim të ruajtjes së pavarësisë, mirepo i shpërfillur nga ana e Fuqive të Mëdha.

Punimi është i ndarë në kapituj, ku në secilin kapitull do të diskutoj për qështjen e Kosovës, duke filluar nga aspekti historik e deri tek gjendja reale dhe faktike.

Në kapitullin e dytë, unë diskutoj për vetëdijen kombëtare për vetëvendosje si dhe mbrojtjen e territoreve shqiptare nga shtetet tjera, sidomos nga armiku kryesor Serbia. Poashtu në këtë kapitull do të diskutoj për ndikimin e Konferencës së Versajës dhe zbatimin e parimit të vetëvendosjes deri në Luftën e Dytë Botërore. Ishte kjo Konferencë ajo që ia dhuroi Kosovën Serbisë. Gjithashtu do të flasë për statusin e Kosovës brenda shtetit të ri të posaformuar, Mbretërisë së Jugosllavisë. Kosova gjatë kësaj periudhe nuk do të ketë ndonjë status ligjor derisa të drejtat themelore të njeriut ndaj shqiptarëve në Kosovë do të shpërfillen.

Në kapitullin e tretë, unë diskutoj për parimin e vetëvendosjes, gjenezën e saj, si dhe fillimin e përkrahjes së këtij parimi, poashtu do të flasim edhe për rastin e Kosovës në veqanti. Gjithashtu në këtë kapitull do të shtjellojm kartën e OKB-së, ku në të bënë fjalë për parimin e vetëvendosjes.

Në kapitullin e katërt, diskutoj për shpërbërjen e ish Jugosllavisë dhe gjendjen juridiko-kushtetuese të Kosovës. Në këtë kapitull do të flasim për kushtetutat e ish jugosllavisë, si u bënë padrejtesitë ndaj Kosovës, si i'u mohua vetëvendosja e popullit të Kosovës në Konferencën e Bujanit më 1943/1944. Pastaj përmisimin e gjendjes së shqiptarëve me kushtetutën e vitit 1968-1974, si dhe përkeqsimi i situatës së Kosovës që nga viti 1987, me vizitën e Millosheviqit në Kosovë, që fillon edhe shpërberja e ish Jugosllavisë, ku Kosovës në vitin 1989 iu suprimua autonomia kushtetuese e saj në mënyrë të dhunshme nga forcat serbe që rrethuan kuvendin e Kosovës.

Në kapitullin e pestë, diskutoj për parimin uti posidetis, kuptimin e këtij parimi në aspektin terminologjik, do të cekim gjithashtu disa qështje me rëndësi që kanë të bëjnë me parimin uti posidetis, si dhe rastin e Kosovës duke iu referuar këtij parimi të rëndësishëm të së drejtës ndërkombëtare. Poashtu në këtë kapitull do të flasim për rolin e komisionit Badinter në lidhje me shpërbërjen e ish jugosllavisë dhe eliminimin e Kosovës nga ky komision duke përjashtuar Kosovën si element konstituiv të federatës jugosllave në aspekt të krahinës, ku ajo kishte kufijt e saj administrativ si gjitha republikat tjera.

Në kapitullin e gjashtë, do të diskutoj për vetëvendosjen (rasti i Kosovës), si dhe qështjen e shkëputjes (secesionit). Gjithashtu këtu bëjmë disa krahasime të rasteve që kanë ndodhur në vende të ndryshme me rastin e Kosovës.

Në kapitullin e shtatë, në këtë kapitull përfshihet konkluzioni rreth kësaj teme ku do të shpjegojm rastin e Kosovës për vetëvendosje, duke u bazuar në tre faktorë: historik, juridik dhe ate të të drejtave të njeriut.

Në kapitullin e tetë, përfshihet literatura që është përfshirë në këtë punim, me qëllim të përforcimit të argumenteve në lidhje me rastin e Kosovës për vetëvendosje.

## KAPITULLI I

### I / 1.RILINDJA KOMBËTARE-SHQIPTARE DHE ZHVILLIMI I VETËDIJES KOMËTARE PËR VETËVENDOSJE

Vetëdija kombëtare për vetëvendosje e popujve të Ballkanit ishte ngritur që nga Deklarata Amerikane 1776 dhe Revolucioni Francez në vitin 1789. Shek.19-të hapi një epokë të re në Ballkan, filloi krijimi i shteteve të reja, ku vullneti i popullit shqiptarë nuk u muar për bazë nga fuqit e mëdha. Gjatë kësaj kohe, aspiratat Ruse përkrahnin pansllavizmin, në anën tjetër shqiptarët kishin një përkrahje shumë të vogël nga Fuqitë e Mëdha. Të gjendur para një zhvillimi të tillë, shqiptarët filluan konsolidimin politik, duke parë se e vetmja zgjidhje ishte lufta për autonomi mbrenda Perandorisë Osmane, ku përfshiheshin të gjitha tokat shqiptare. Zgjerimi i territorit të Serbis kishte filluar që nga viti 1737 me dëbimin e shqiptarëve nga tokat e tyre, pastaj në vitin 1804 dëbimin e shqiptarëve nga Nishi, duke i detyruar të emigronin në tokat shqiptare që sot gjenden në Kosovë<sup>1</sup>. Shqiptarët duke parë rrezikun nga shtetet fqinje dhe të vetmen zgjidhje për autonomi filluan përpjekjet për kontrollë të trojeve shqiptare, ku kishte qar deri tek formimi i dy pashallëqeve shqiptare që kontrollonin pjesë të caktuara të territorit. Duke parë rrezikun Perandoria Osmane filloi ekspedita ushtarake për t'i rifituar ato si dhe tentuan të shpallnin reforma të ndryshme ushtarake, tatimore etj, ku quan deri tek revoltat e shqiptarëve gjatë viteve 1843-45, mirëpo këto revolta kishin përfunduar pa suksese pasi Sulltani kishte dërguar armatë të madhe ushtarake për t'i shtypur ato. Pas këtyre ngjarjeve pasuan reformat që kishte shpallur Perandoria Osmane në vitin 1867, duke bërë ndarje të reja administrative ku kishte krijuar krahina të quajtura Vilajete. Vilajeti i Kosovës përfshinte katër ndarje administrative më të vogla të cilat quheshin sanxhaqe, me qytetin kryesor administrativ Prizrenin. Pas Kongresit të Berlinit qendra administrative ishte zhvendosur në Prishtinë deri në vitin 1888<sup>2</sup>.

---

<sup>1</sup>Judah, Tim, Kosovo, WAR AND REVENGE, Yale University, Bolton, Usa, (2002), fq.- 11-12

<sup>2</sup>Po aty, fq.- 192-201

Marrevëshja e Shën Stefanit ( 3 mars) e vitit 1878 në mes Perandorisë Osmane dhe Ruisë dhe në anën tjetër zgjerimin e kufijve në drejtim të tokave shqiptare nga ana e serbëve, me aspiratat e tyre që u bënë publike në planin e njohur “Necertania” e Garashaninit (Plani) në vitin 1884, nxiti politikan dhe patriotë shqiptarë të bashkoheshin për mbrojtjen e kufijve të tyre dhe krijimin e shtetit shqiptarë<sup>3</sup>. Të shqetësuara nga mundësia e influencimit Rusë mbi dominionet evropiane që kishin qenë mbi Perandorinë Osmane, Fuqit e Mëdha dhe Britania e Madhe filluan përpjekjet për rregullimin e problemit të Ballkanit, ky problem u bë qështje e Kongresit të Berlinit. Duke parë rrezikun që po i kanosej, në këtë kohë filluan përpjekjet e unifikimit shqiptarë ku do të kenë një platformë unike. Ky proces u përmbyll me 10 qershor 1878, në kongresin mbarëshqiptarë të mbajtur në Prizren i quajtur Lidhja e Prizrenit. Qëllimi i Lidhjes së Prizrenit ishte që t’ju tregoj fuqive të mëdha për ekzistencën e veqant të interesave kombëtare të popullit shqiptarë dhe poashtu qëllim parësor ishte që të ndaloj çdo lloj okupimi të territoreve shqiptare nga trupat e huaja. Përkundër të gjitha përpjekjeve shqiptarët nuk u lejuan të merrnin pjesë në Kongresin e Berlinit, mirëpo Lidhja e Prizrenit ishte e detyruar që programin e saj ta prezentoj përmes përfaqësuesit britanez. Qëndrimi i shqiptarëve në këtë kongres ishte kundër ndarjes së territoreve shqiptare dhe kishin lënë të kuptohet se në rast të coptimit ata do të mbrojnë me forcë po të jetë nevoja. Kërkesat kryesore të shqiptarëve ishin: 1) të bashkohen të gjitha territoret shqiptare në një vilajet; 2) të gjithë shërbyesit zyrtarë të cilët punojnë në territoret shqiptare duhet të flasin dhe shkruajnë në gjuhën shqipe; 3) zhvillimi i shkollimit në gjuhën shqipe dhe 4) ndarja e shumës së caktuar të fondeve nga të ardhurat e përgjithshme të vilajetit për zhvillimin e shkollimit dhe rikonstruktimeve publike<sup>4</sup>. Kongresi i Berlinit përfundimisht nuk mori parasysh kërkesat e shqiptarëve dhe injoruan ekzistencën e popullit shqiptarë përkundër përkrahjes tepër të vogël nga Austro-Hungaria. Rezultat i këtij kongresi ishte t’i shpërblejë Serbin dhe Malin e zi me territore shqiptare në pjesën veriore (Piroti, Vranja, Nishi, Tivari, Podgorica, Plava, Gucia, Rugova dhe Kolashini) të cilat i përkisnin Vilajetit të Kosovës<sup>5</sup>.

---

<sup>3</sup>A.R. Marriot, John, THE EASTERN QUESTION: AN HISTORICAL STUDY IN EUROPEAN DIPLOMACY, Oxford, Clarendon Press, (1917), fq.- 283

<sup>4</sup>Rexha, Iljaz, Lidhja e prizrenit në Dokumentet Osmane, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, (1978), fq.- 43-45

<sup>5</sup>Po aty, 1, fq.- 228-229



## **I / 2. Coptimi i trojeve shqiptare, mobilizimi i shqiptarëve për bashkim dhe vetëvendosje**

Pas këtyre coptimeve që i'u bënë trojeve shqiptare nga Kongresi i Berlinit 1878, ishte radha për më shumë coptime të trojeve shqiptare kësaj radhe përmes luftrave ballkanike të vitit 1912-1913. Gjatë këtyre luftrave serbët, malazetët, grekët kishin pushtuar shumicën e trojeve shqiptare. Shqiptarët kishin rifilluar kryengritjet e tyre në vitin 1908 dhe ishin shtrirë gjatë gjithë territoreve shqiptare deri në vitin 1912 kur edhe ishte shpallur pavarësia e Shqipërisë. Gjatë këtyre luftrave ballkanike ( I dhe II) si dhe “krizës lindore”, Shqipëria ishte objekt dëshirash për t'u coptuar nga fqinjët ballkanas: Italia, Greqia, Mali i Zi dhe Serbia.

Konferenca e Ambasadorëve në Londër në vitin 1913 ishte mbledhur që t'i jap fund luftrave ballkanike dhe shqyrtimin e vijave të reja kufitare. Austro-Hungaria kundërshtonte ndërhyrjet sllave në territoret e Ballkanit si dhe frika nga vendosja e pranisë Ruse në Mesdhe, ku Austro-Hungaria përkrahi krijimin e një shteti shqipëtar, mirëpo ata nuk u njohën si kombe edhe pse ajo kishte identitetin e saj kulturor, gjuhësor, historik. Në vitin 1913 Kosova i'u nda Serbisë, në bazë të vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve 1913, i cili vendim do të konfirmohej në Konferencën e Paqes në Versajë 1919. Qëllimi i Konferencës së Versajës ishte ndalimi i Luftës së Parë Botërore (1914-1918), krijimi i një rendi të ri botëror si dhe krijimin e organizatës së parë ndërshtetërore globale, apo univerzale që u quajt Liga e Kombeve ose Lidhjen e Kombeve. Me Traktatin e Versajës dhe Konferencën e Parisit 1919, u krijuan shumë shtete të reja sllave në ballkan, ku disa prej këtyre shteteve u bazuan në parimin e vetëvendosjes, derisa të tjerat ishin krijuar në bazë të disa koncesioneve gjeopolitike, pa vullnetin e lirë të popujve përkatës. Një rastë tjetër ishte formimi i Mbretërisë Serbo-Kroato-Sillovene e cila më vonë njihet si Mbretëria e Jugosllavis, ku qëllimi i formimit të saj ishte përfaqësimi i grupeve të ndryshme etnike, mirëpo e vërteta e gjithë kësaj ishte se ajo dështoi t'i përfaqësonte ato, duke vërtetuar krijimin artificial të saj<sup>6</sup>.

Parimi i vetëvendosjes që u avancua nga presidenti Amerikan Woodrow Wilson në dokumentin e tij që njihet me emrin: ”Programi prej 14 pikash”, nuk ishte zbatuar njëjtë nga Fuqitë e Mëdha, por përkundrazi ajo u shfrytëzua për interesat e tyre vetjake.

---

<sup>6</sup>I. Woodward, Susan, BALKAN TRAGEDY: CHAOS AND DISSOLUTION AFTER THE COLD WAR, Brookings Institution Press, Washington D.C, (1995)

Poashtu ato lejuan krijimin e shteteve që kishin fatin të ishin në anën e fituesit pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, në mënyrë që të mund të jenë mburojë ndaj shteteve të mposhtura, si dhe kufizimin e ekstremizmit socialistë që kishte marrë në Rusi në vitin 1917<sup>7</sup>.

Gjatë kësaj periudhe të formimeve të ndryshme shtetërore, Fuqitë e Mëdha me qëllim të balancimit të politikave të tyre ndaj disa kombësive që kishin mbetur mbrenda shteteve tjera, përpilojn marrëveshjen për mbrojtjen e minoriteteve dhe që duhej të zbatohet kjo nga shtetet dhe në këtë rast siq ishte Mbretëria Jugosllave që ishte okupator i popullit shqiptarë dhe përfaqësonte disa grupe etnike mbrenda saj, ajo nënshkroi deklaratën për mbrojtjen e minoriteve. Kjo deklaratë ishte e kategorizuar në disa pjesë, në Kategorin e parë përfshiheshin shtetet e mposhtura të Austrisë, Hungarisë, Bullgarisë dhe Turqisë. Kategoria e dytë përfshinte shtetet e reja që kishin lindur me rastin e shkatrrimit të Perandorisë Osmane. Kategoria e tretë përfshinte disa raste specifike që kishin të bënin me territoret Aland, Danzig, Meml dhe Silesia e Epërme. Megjithë këto kategori të ndara ku qëllimi i tyre ishte mbrojtja minoritare tradicionale që kishte të bënte me religjionin, gjuhën dhe aktivitetet kulturore, mirëpo kjo nuk nënkuptonte kuptim më të gjërë që do kishte të bënte me autonomi politike apo ekonomike. Megjithkëtë minoritetet ishin lejuar që të kenë të drejt lobimi në Paris, pa të drejt vendimmarrje në vend. Mirëpo përfaqësuesit serbë refuzonin të njihnin dhe të legjitimonin popullin shqiptarë në Kosovë, me qka kishin refuzuar të adresonin qështjen e minoriteteve që jetonin në jug të vendit. Në këtë rast ishte kundërshtuar ekzistenca e popullit shqiptarë dhe Kosova ishte bërë sinonim i shkeljeve të të drejtave të njeriut. Serbët insistonin në atë që deklarata duhej të zbatohet ndaj atyre territoreve që ishin marrë nga Austro-Hungaria, edhe pse referenca në marrëveshje që përcaktonte për “të gjitha territoret e marra nga Serbia dhe Mali i zi nga janari i vitit 1913” pohon të kundërtën<sup>8</sup>.

Gjendja e popullit shqiptarë gjithnjë e më shumë vështirsohej nga shteti centralist Jugosllavë që kishte instaluar aparatin e saj centralizues në ditën e Vidovdanit, që ndryshe njihet edhe si “Kushtetuta e Vidovdanit” e vitit 1921. Jugosllavët jo vetëm që përjashtonin shqiptarët, mirëpo edhe popujt e tjerë, ata ishin të lirë që t’u vërsuleshin të gjithë atyre që kundërshtonin coptimin e territoreve.

---

<sup>7</sup>Po aty, fq.- 52-55

<sup>8</sup>Bennett, Christopher, YUGOSLAVIA’S BLOODY COLLAPSE: CAUSES, COURSE AND CONSEQUENCES, C. Hurst & Co. Publishers, London, (1995), fq.- 36-37

Nga gjendja e vështirë dhe mjeruese e shqiptarëve që nuk i'u respektohej e drejta për jetë, liri, shprehje, me një fjalë liritë fundamentale të njeriut, prijësit fetarë shqiptarë kishin prezantuar një peticion Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve me datë 05 maj 1930, në këtë letër ata kishin theksuar që autoritetet jugosllave kishin dështuar të zbatonin Deklaratën për mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve e cila ishte nënshkruar nga Mbretëria Jugosllave. Peticioni përmbante tetë anekse kryesore që kishin të bënin me mos respektimin e artikujve 2, 3, 7, 8, 9, 10. Këtu përfshihej: 1) mbrojtjen e jetës, 2) mbrojtjen e lirisë, 3) mbrojtjen e pronës, 4) të drejtat civile dhe juridike, 5) e drejta e përdorimit të gjuhës, 6) e drejta për themelimin e shkollave private dhe organizatave bamirëse, 7) e drejta në shkollimin publik dhe 8) e drejta në religjion. Peticioni poashtu kishte nënvizuar tri shkelje që ishin drejtuar kundër shqiptarëve si popullë: 1) përndjekja që t'i shtyjë shqiptarët t'i lëshojnë tokat e tyre, e cila kishte rezultuar me më shumë se 140 000 shqiptarë të zhvendosur në Turqi, Shqipëri dhe vende tjera, 2) përdorimi i forcës dhe dhunës me qëllim të asimilimit të popullit të pambrojtur dhe 3) persekutimi dhe shkatërrimi personave që refuzonin të lëshonin tokat e tyre ose të asimilohen dhe të serbizohen<sup>9</sup>. Peticioni poashtu kishte kritikuar Lidhjen e Kombeve për neglizhencën e saj dhe që nuk kishte bërë më shumë në mbrojtjen e minoriteteve dhe kërkesa e shqiptarëve ishte që Lidhja e Kombeve të formonte një komision ndërkombëtar për mbikqyrjen e zbatimit të marrëveshjes për minoritete. Fatkeqësia e gjithë kësaj përpjekje ishte që kishte dështuar të bindë komunitetin ndërkombëtar për një gjë të tillë.

Gjatë viteve 1920 shqiptarët duke parë faktorin ndërkombëtar për mos interesimin e saj ndaj popullit shqiptarë, ata organizojn njësitë guerile të cilët quheshin kaqak. Komiteti i Kosovës që ishte formuar më herët që të lobonin qeverinë Amerikane që të mbronin interesat kombëtare shqiptare, kishte marrë udhëheqjen e organizimit të lëvizjes së kaqakëve brenda Kosovës. Qëllimet e vetëvendosjes dhe ndarjes paqësore ishin përshkruar në rregullat përgjithshme të lëvizjes që përfshinin dy pika parimore: 1) nuk do të ngrihen armët kundër serbëve lokale, 2) askush nuk guxon të djegë ndonjë shtëpi apo të shkatërroj ndonjë kishë.

---

<sup>9</sup>(Një peticion I prezantuar Lidhjes së Kombeve nga Don Bisaku, Don Kurti, Don Gashi, Situata e minoriteteve në Jugosllavi)

Shqiptarët kishin tentuar që në mënyrë diplomatike të zgjidhnin problemin me serbët, para fillimit të rezistencës, ata ishin takuar me zyrtarë serbë dhe i kishin paraqitur kërkesat e tyre që ishin: e drejta për vetëvendosje; ndalimin e vrasjeve së shqiptarëve dhe marrja e tokave; përfundim të planit të kolonizimit; përfundim të aksioneve ushtarake të zhvilluara me pretekst të çarmatimit dhe përfundim të proceseve internuese ndaj familjeve të kryengritësve. Autoritetet serbe kishin tentuar të arsyetonin këto kërkesa në mënyra të ndryshme jo faktike<sup>10</sup>.

Lufta e Dytë Botërore kishte filluar më 1939, me pushtimin e Polonisë nga Gjermania. Jugosllavia (përfshirë edhe Kosovën) kishte rënë nën pushtimin gjerman gjatë prillit 1941, ndërsa Shqipëria nën sundimin Italian. Më 20 Prill të vitit 1941, në bazë të një marrëveshje të ministrave të jashtëm gjerman dhe italian, Kosova i'u kishte bashkuar Shqipërisë. Në bazë të një dekreti në tetor të vitit 1941 dhe shkurt i vitit 1942, qeveria italiane iu kishte dhënë shtetësi shqiptare të gjithë popujve që jetonin në Kosovë<sup>11</sup>.

Me përfundimin e Luftës së Dytë Botërore, kishin filluar riformulimet e rendit botëror, shqiptarët ishte e qartë që donin të i korigjonin vendimet e bëra pa pëlqimin e tyre, duke u fokusuar në parimin e vetëvendosjes. Kjo vendosshmëri e shqiptarëve bëhet më qartë pas planeve të serbëve me në krye Stevan Moljevic që në qershor të vitit 1941 që kishin hartuar një plan të ri për “Serbinë e Madhe”, të quajtur: “Serbia Homogjene”. Në këtë planë ishte postuar një ide që serbët kishin kundërshtuar të parët pushtimin gjermanë dhe kështu ata kishin fituar të drejtën për të drejtuar me ardhmërinë e Ballkanit<sup>12</sup>. Shqiptarët kishin luftuar fuqishëm kundër ripërfshirjes në shtetin jugosllav. Serbët kishin në mënyrë që t'i shuajn ndjenjat kombëtare dhe të formojn partinë komuniste në Kosovë, partia komuniste jugosllave kishte luajtur me kartën e vetëvendosjes. Në dhjetor të vitit 1943, me leje të komunistëve jugosllavë nga Kosova, Partia Komuniste Shqiptare kishte propaganduar të drejtën e vetëvendosjes deri në shkëputje nga shteti. Pas kësaj në Konferencën e Bujanit 1944, ku kishin marrë pjesë shqiptarët, malazezët dhe serbët, në këtë konferencë shqiptarët dëshirë dhe kërkesë kishin vetëvendosjen që edhe ishte paraqitur

---

<sup>10</sup>Malcom, Noel, Kosovo, A Short History, KOHA Prishinë, (2001),

<sup>11</sup>Po aty, 1, fq.- 46-52

<sup>12</sup>Po aty, fq.- 307

në dokumentin e quajtur Rezoluta e Bujanit 1944, për vetëvendosje dhe bashkim me shtetin amë Shqipërinë, mirëpo kjo rezolutë e aprovuar aty, ishte injoruar totalisht nga ana e serbëve<sup>13</sup>.

Shqiptarët të paknaqur kishin filluar të i mbronin të drejtat e tyre me forcë, ku partizanët dhe komandantët shqiptarë luftonin kundër nacionalistëve dhe grupeve paramilitare serbe të quajtura “Çetnik” deri në vitin 1945, ku gjatë kësaj kohe kishin vrarë mbi 20 000 persona<sup>14</sup>. Pas Konferencës së Bujanit serbët manipulojn për nxitjen e formimit “Parlament të Kosovës”, në të cilën Kosova i bashkohej “Serbisë Federale” në korrik të vitit 1945, Lenini këtë vendim e kishte definuar si shprehje të vullnetit të lirë. Kjo nënkupton, derisa njëherë një popull shpreh vullnetin e tij të lirë, nuk mund ta marrë atë të drejtë përsëri. Serbët më pastaj do të marrin këtë pozicion që t’i arsyetojnë qëndrimet dhe veprimet e tyre.

Kushtetuta e miratuar në vitin 1946 nga Jugosllavia e dytë, kishte njohur shqiptarët si një minoritet kombëtar. Përkundër kësaj, koha e pas luftës, e njohur në mesin e shqiptarëve si koha e Aleksander Rankoviçit, kishte rezultuar në shpërngulje masive të shqiptarëve nga Kosova. Gjatë kësaj kohe shqiptarët poashtu i ishin nënshtruar një procesi të kolonizimit, arrestimeve masive dhe dominimit institucional nga ana e serbëve dhe malazezëve<sup>15</sup>. Një situatë e tillë kishte vazhduar deri në fund të viteve të 1960-ta kur aparati policor i Rankoviçit ishte shkarkuar nga Kosova. Pas kësaj periudhe, serbët dhe malazezët kishin humbur të drejtën e dominimit në institucionet politike dhe shtetërore, derisa shqiptarët ishin liruar që në mënyrë publike t’i shprehin kërkesat e tyre. Këtë gjë shqiptarët e kishin bërë me anë të demonstratave gjatë vitit 1968 kur ata kërkuan një status të njëjtë ligjor sikurse kishin edhe republikat e tjera brenda Jugosllavisë. Kjo gjendje kishte qar deri tek disa ndryshime kushtetuese të cilat në mënyrë të pjesërishme kishin plotësuar kërkesat e shqiptarëve, sidoqoft kërkesa e tyre për universitet ishte mohuar në këtë kohë<sup>16</sup>.

Realiteti i ri dhe presioni nga republikat e tjera, rezultuan në miratimin e amandamenteve kushtetuese të RSFJ-së në vitet 1968, 1971 dhe 1974, të gjitha këto amandamente ishin përfshirë

---

<sup>13</sup>Repishti, Sami, Rezoluta e Bujanit 2 janar 1944, Një analizë, studime historike, fq.- 92

<sup>14</sup>Hasani, Dr. Enver, Shpërbërja e ish-jugosllavisë dhe Kosova, Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare, Tiranë, (2000), fq.- 21

<sup>15</sup>Po aty, 13, fq.- 317-318

<sup>16</sup>Po aty, 10, fq.- 38-39

në kushtetutën e vitit 1974. Me Kushtetutën e vitit 1974, Kosovës i përcaktohet statusi i një krahine autonome, me definime të qarta kufitare dhe fuqi që të aprovojë ndryshimet kushtetuese.

Të gjitha krahinat ishin konsideruar si të barabarta dhe përgjegjëse në përcaktimin dhe ekzekutimin e politikave federale e po ashtu edhe të marrin pjesë në procesin vendimarrës në nivel të federatës. Kjo do të thotë që Kosova kishte të drejtën e vetos.

Pozicioni juridik kushtetues i Kosovës ishte karakterizuar me dy faktorë kryesorë: I pari kishte karakterizuar Kosovën si njësi politiko-territoriale, ndërsa I dyti kishte karakterizuar atë si një element konstituiv të federatës jugosllave.

Karakteristikë kryesore kushtetuese e faktorit të parë ishte pavarësia në integritetin territorial, gjyqësor, financiar ekonomik, mbrojtje të kushtetutës dhe legjislacionit, punë të brendshme, marrëdhënie ndërkombëtare dhe në mbajtje të rendit duke siguruar sigurinë dhe mbrojtjen kombëtare. Sipas të dytit, Kosovës i jepet një pozitë e avancuar brenda strukturës së federatës jugosllave. Kjo do të thotë që, derisa Kosova ishte konsideruar si pjesë përbërëse e federatës jugosllave, ajo kishte territorin dhe kufijt e saj sikurse edhe republikat tjera. Kosova ishte njëra nga tetë njësitë federale e cila kishte kryetarin e saj, bankën kombëtare dhe trupat e tjera administrative me fuqi dhe detyra mirë të definuara. Po ashtu, Kosova kishte diskrecion në marrëdhëniet ndërkombëtare e përcaktuar me kornizën mbi punët e jashtme të definuara nga jugosllavia në marrëveshjet ndërkombëtare. Kosova ishte e përfaqësuar në Dhomën e Republikave dhe Krahinave në parlamentin e Jugosllavisë ku kishte të drejtë në propozimin e ligjeve dhe akteve të tjera juridike. Ajo poashtu ishte e përfaqësuar në Këshillin Ekzekutiv Federativ, Gjyqin Kushtetues të jugosllavisë dhe organet e tjera federale, Kosova kishte një pozitë të njëjtë me republikat e tjera në lidhje me procedurën e aprovimit dhe ndryshimit të kushtetutës së jugosllavisë<sup>17</sup>. Mirëpo përkundër kësaj, kushtetuta e re nuk kishte avancuar statusin e Kosovës në atë të republikës, e cila ishte kërkesa kryesore e shqiptarëve të Kosovës. Po ashtu kushtetuta e re nuk kishte kënaqur serbët të cilët kishin filluar me paraqitjen e nacionalizmit. Pas vdekjes së Titos, në vitin 1981 shqiptarët edhe njëherë kishin dalë në rrugë për të demonstruar, duke kërkuar të drejtat e tyre legjitime për statusin e republikës brenda

---

<sup>17</sup>Po aty, 13, fq.- 23

sistemit federal. Shqiptarët besonin që kjo mënyrë ishte e vetme pasi që bisedimet formale në nivelin e federatës nuk dërgonin askund.

Këto demonstrata ishin shtypur me dhunë për herë të parë në Kosovë, policia kishte përdorur armët e zjarrit kundër demonstruesve. Serbia kishte përdorur këto demonstrata mëpastaj si një pretekst që të rrethonte të gjithë vendin dhe të dërgoj forcat speciale të cilat në mënyrë brutale do t'i shtypnin demonstruesit. Më shumë se 200 persona ishin vrarë, mëpastaj kishte filluar shkarkimi nga puna i të gjithë atyre personave “fajtorë për diversifikim ideologjik” nga institucionet kosovare, shumë shqiptarë ishin arrestuar, ishin bërë gjykime të shpejta dhe shumë demonstrues ishin burgosur deri në 15 vjet.

Politikanët serb kishin tentuar të shfrytëzojnë lëvizjet e mundshme në mënyrë që t'i portretizojn shqiptarët si një popull i cili mund të destabilizojn jugosllavin. Mirëpo në fakt ishin vetë propagandat dhe apetitet hegjemoniste të serbëve ato të cilat destabilizuan jugosllavinë. Serbët në mënyrë që të rritnin nacionalizmin në mesin e serbëve, Lidhja e Komunistëve të Serbisë kishte organizuar një sesion nga 24 deri 26 dhjetor të vitit 1981, që u kishte kushtuar marrëdhënieve ndëretnike brenda jugosllavisë. Në këtë mbledhje serbët pretendonin se ekzistimi i dy krahinave (Kosovës dhe Vojvodinës) brenda serbisë kishte shkukur unitetin kushtetues. Gjatë këtij sesioni figura politike serbe Drazha Marković, kishte theksuar që Jugosllavia në fakt përbëhej prej pesë kombeve: serbëve, malazezëve, kroatëve, maqedonëve dhe sllovenëve. Kjo ishte një kërcënim për Kosovën, Vojvodinën dhe Bosnjën<sup>18</sup>. Më 1986, një grup intelektualësh serbë nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Serbisë, në mënyrë jo zyrtare kishin përgatitur një Memorandum famëkeq që të nxiste nacionalizmin serb. Sipas këtyre intelektualëve, kroatët në emër të Titos dhe sllovenët në emër të Edvard Kardelit, në mënyrë të qëllimshme kishin konstruktuar federatën jugosllave që të eksploatonin Serbin nga ana ekonomike. Ky memorandum fajësonte Titon, për kinse, përpjekjen për të dobësuar serbin me kushtetutën e vitit 1974, duke formuar dy krahina autonome të Kosovës dhe Vojvodinës nga Serbia. Ky memorandum kishte shkuar aq largë sa që pretendonte të vendoste serbët në pozita të viktimës së

---

<sup>18</sup>P. Ramet, Sabrina, Views from Inside, Memoirs Concerning the Yugoslav Breakup and War, Slavic Review, Cambridge University Press, UK, (2002), fq.- 558-580

gjenocidit nga shqiptarët “iridentiste dhe separatiste”, përkundër protestave, Akademia asnjëher nuk e kishte mohuar por as që kishte publikuar ndonjë version zyrtar të Memorandumit<sup>19</sup>.

Në këtë kohë të gjendjes së vështirë ekonomike, ku kjo krizë ekonomike kishte ardhur si rezultat i borxheve të mëdha ndërkombëtare, ku kreditorët perëndimorë kishin ndaluar të jepnin hua të pakontrolluara që kishin bërë gjatë viteve 1970-ta, kohë në të cilën nacionalizmi serb ishte në rritje, i hapi rrugë ardhjes së një diktatori serb siq ishte Slobodan Millosheviq, që statusi i tij politik kishte filluar të shihej në fund të viteve 1980-ta. Millosheviqi arriti të merrte pushtetin në duar duke kombinuar nacionalizmin me krizën ekonomike, siq kishin bërë japonezët, gjermanët gjatë krizës botërore para Luftës së Dytë Botërore. Poashtu pasi erdhi në pushtet Millosheviqi, Akademia e Shkencave dhe e Arteve kishte përpiluar Memorandumin famëkeq duke krijuar situatë tronditëse përgjatë Jugosllavisë. Gjithashtu edhe historianët serbë kishin filluar të rishqyrtonin historinë në mënyrën e tyre, poashtu filluan dezinformatat për kinse dhunë e shqiptarëve ndaj popullatës serbe me qëllim që policia dhe ushtria serbe të shtrihej më shumë në vendbanimet shqiptare<sup>20</sup>. Në vitin 1987, Millosheviqi kishte organizuar një miting në Fushë Kosovë ku ai i adresojë popullatës së mbledhur pra serbe, duke ju thënë se “askush nuk guxon të ju prekë juve”. Emocionet e serbëve ishin nxitur edhe më shumë në vitin 1989, kur eshtrat e mbretit Lazar të Serbisë kishin qarkulluar përgjatë Kosovës që ti zgjonin ndjenjat nacionaliste të serbëve, para se ato eshtra të rivarroseshin në Graçanicë. Duke filluar nga vitet 1980-ta dhe me intensitet më të madhë ndërmjet viteve 1985-1990, të gjitha vendet e banuara me serb ishin vënë nën komandën e armatës së Beogradit. Kulmi i gjithë kësaj ishte në vitin 1989, kur regjimi i Beogradit filloi rrënimin e autonomisë së Kosovës. Presidenca federale në mënyrë të njëanshme kishte aprovuar ndryshimet kushtetuese duke shkelur kushtetutën e Jugosllavisë e cila kërkonte pëlqimin e Kosovës dhe të parlamentit federal. Me këtë veprim ishte shkatërruar autonomia politike dhe ekonomike e Kosovës<sup>21</sup>.

Gjatë kësaj kohe kur gjendja po përkeqsohej gjithnjë e më shumë dhe poashtu kishte filluar të shkatërrohej Jugosllavia, ishte bërë një përpjekje e fundit për të shpëtuar sistemin federal, mirëpo këto përpjekje kishin dështuar për shkak të nacionalizmit të tepruar dhe dallimeve ekonomike

---

<sup>19</sup>Hanum, Hurst, *Autonomy, Sovereignty, And Self-Determination: The Accommodation of Conflicting Rights*, University of Pennsylvania Press, USA, (1996), fq.- 321-322

<sup>20</sup>Po aty, 10, fq.- 56

<sup>21</sup>Po aty, 3, fq.- 208-209



ndërmjet republikave. Qëllimi i Millosheviqit ishte të ketë një Jugosllavi të centralizuar nën dominimin serb. Ai përdori popullatën serbe që të revoltohej dhe të ndaheshin në mënyrë që ata të inkorporoheshin në Serbi. Ky skenar do të qonte në luftëra të përgjakshme.

Qështja e sovranitetit shtetëror doli të jetë e komplikuar për shkak të paqartësive në definimin e vetë termit: A ishte populli apo ishin republikat bartëse të sovranitetit? Serbët përkrahnin konceptin e sovranitetit popullor derisa republikat tjera përkrahnin konceptin sovranitetin territorial<sup>22</sup>. E vetmja Sllovenia kishte të qarta dy elementet kryesore, popullsinë dhe kufijtë, ndërsa pjesa tjetër e Jugosllavisë kishte situatën e ndërlikuar. Ishin Kroacia dhe Sllovenia këto të cilat kërkonin një konfederatë më të brishtë dhe reforma politike në nivelin federativ. Në republikat e tyre ata kishin aprovuar sistemin shumë partiak dhe kishin bërë ndryshime kushtetuese. Një amandament i rëndësishëm i kushtetutës së Sllovenisë përcaktonte të drejtën e Sllovenisë për ndarje nga federata pa ndonjë pëlqim të shumanshëm me republikat tjera<sup>23</sup>. Poashtu edhe republikat tjera kishin filluar të bënin ndryshime dhe të lejonin së funksionuari sistemi shumëpartiak dhe kishin organizuar zgjedhje. Kryeministri i fundit Jugosllav, Ante Markoviqi kishte bërë përpjekje për të bërë reforma ekonomike me besimin që do të mbante vendin të bashkuar, mirëpo reformat ekonomike nuk ishin përcjell me reforma politike dhe u bë e qartë se mbajtja e vendit të bashkuar kërkonte më shumë se disa reforma ekonomike<sup>24</sup>.

Një kontribut të rëndësishëm në shkatërrimin dhe biznesin e përgjakshëm të filluar në vitin 1991 kishin dhënë zgjedhjet, ku në gjashtë republikat, partitë antikomuniste kishin fituar në katër republika, ndërsa ish-komunistët kishin fituar në dy republika, në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në Malin e zi që përkrahnin Millosheviqin. Millosheviqi kundërshtonte një konfederatë të brishtë, ai gjithnjë tentonte një sistem më të centralizuar<sup>25</sup>. Kjo u vërtetua me Kongresin e 14-të të jashtëzakonshëm të LKJ-së të thirrur nga Millosheviqi në janar të vitit 1990. Në këtë kongres, presidenti i Sllovenisë Milan Kučan, ishte ndaluar nga Millosheviqi kur ai tentoi të propozonte një konfederatë më të brishtë. Pas këtij veprimi delegacioni slloven kishte lëshuar kongresin më

---

<sup>22</sup>Po aty, 19, fq.- 353

<sup>23</sup>Po aty, fq.- 19

<sup>24</sup>Po aty, fq.- 359

<sup>25</sup>Po aty, 9, fq.- 110-111

20 janar për të mos u kthyer më, të njëjtën lëvizje e kishin bërë edhe Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina dhe Maqedonia, për ta mbyllur tërësishtë mbledhjen<sup>26</sup>.

Pengesa tjetër ndaj dëshirave të Millosheviqit për dominim dhe ricentralizim të Jugosllavisë ishin edhe shkatërrimi i Bashkimit Sovjetik dhe lindja e demokracisë në Evropën Lindore. Me rënien e komunizmit, kishte rënë edhe rëndësia e Jugosllavisë në marrëdhëniet ndërkombëtare për t'u mbështetur në botën perëndimore në shpëtimin e saj<sup>27</sup>. Kjo rrethan kishte nxitur që dy republikat veriore, Sllovenia më 1990 dhe Kroacia më 1991. Kjo ndarje në fillim nuk ishte përkrahur nga ana e SHBA-ve. Sekretari i shtetit, James Baker, kishte deklaruar në një vizitë jo zyrtare në Beograd që SHBA-të nuk do njihnin Slloveninë dhe Kroacinë në asnjë rrethanë. Fatkeqësisht, kjo deklaratë do të interpretohej si një leje për përdorimin e fuqisë ushtarake të kufizuar për mbajtjen e Jugosllavisë.

Në fillim të viteve 1990-ta, Komuniteti Evropian kishte sponsorizuar një konferencë për Jugosllavinë në Hagë, ku kjo konferencë kishte deklaruar se nuk do të kishte ndryshime unilaterale të kufijve dhe ishte për mbrojtjen e popujve jugosllav. Në vitin 1992 ishte nënshkruar traktati i Maastricht-it, ku nga pikat më të rëndësishme të mbledhjes ishte qësjtja e njohjes së Sllovenisë dhe Kroacisë. Nën presionet e delegacionit gjerman, komuniteti evropian kishte votuar për të pranuar dy republikat veriore. Kjo lëvizje ishte kundërshtuar nga ana e SHBA-ve për shkak që e njëjta shansë nuk iu kishte ofruar republikave tjera që të shprehnin vullnetin e tyre. Këto kundërshtime dhe vërejtje të SHBA-ve, kishte bërë që shtetet evropiane të punonin në përcaktimin e disa rregullave, të cilat do të përcaktonin standardet për njohjen e shteteve të reja, të cilat do të dilnin nga shkatërrimi i Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë. Një komision arbitrazhi ishte themeluar në konferencën Karington në Hagë dhe ishte udhëhequr nga një jurist kushtetutes francez, Robert Badinter, që të gjykonte rastet për njohjen e republikave. Ky komision pas fillimit të punës kishte pranuar aplikacionet për njohje nga ana e Sllovenisë, Kroacisë, Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Maqedonisë, pasi kishte pranuar aplikacionet komisioni në opinionin e parë kishte theksuar se Jugosllavia ishte në proces të shkatërrimit. Pas këtij procesi të shkatërrimit, Serbia kishte tentuar të manipuloj popullatën serbe që jetonin në Kroaci dhe Bosnjë e Hercegovinë që të kërkonin vetëvendosje.

---

<sup>26</sup>Po aty, fq.- 111

<sup>27</sup>Po aty, 3, fq.- 208-210

Pas kësaj tentative serbia kishte parashtruar nëse popullata serbe që jetonte në Kroaci dhe Bosnjë e Hercegovinë kishte të drejtën e vetëvendosjes dhe nëse kufijtë ndërmjet Kroacisë dhe Serbisë si dhe Bosnjë Hercegovinës dhe Serbisë do të mund të konsideroheshin si kufij ndërkombëtar, në kuptimin e së drejtës ndërkombëtare publike. Komisioni i arbitrazhit në lidhje me pyetjen e parë kishte përfunduar që e drejta për vetëvendosje nuk kuptonte ndryshimin e kufijve ekzistues pas shpalljes së pavarësisë, kështu që parimi uti possidetis do të duhej të përdorej, përveq në rastet kur shtetet me marrëveshje shprehin vullnetin ndryshe. Ndërsa në pyetjen e dytë komisioni i arbitrazhit, kishte deklaruar që Jugosllavia ishte në proces të shkatërrimit<sup>28</sup>. Ai kishte njohur kufijtë e mëhershëm të republikave si kufijë ndërkombëtar dhe në këtë mënyrë këta kufijë ishin të pacënueshëm ndërkombëtarisht dhe poashtu në bazë të kushtetutës së ish-jugosllavisë<sup>29</sup>.

Situata me Sllovenin ishte më e qartë, popullata ishte më homogjene dhe referendumi i organizuar kishte treguar përkrahje për një shtet të pavarur. Kroacia poashtu ishte kualifikuar, mirëpo kushtetuta e saj e 04 dhjetorit të vitit 1991 nuk parashihte ndonjë garancion për mbrojtjen e minoriteteve. Komisioni Evropian kishte njohur dy republikat, Kroacinë dhe Slloveninë më 15 janar 1992. Në lidhje me Bosnjën e Hercegovinën komisioni kishte marrë vërejtjen për deklaratën e përgatitur nga ana e serbëve të Bosnjës më 10 nëntor 1991, e cila theksonte që ata dëshirojnë të mbesin brenda Jugosllavisë, pra në qoft se Bosnja dhe Hercegovina ndahet nga Jugosllavia deklarata shprehte qëndrimin që serbët dëshironin të themelonin një shtet të pavarur serb nga Bosnja dhe Hercegovina. Komisioni kishte deklaruar që vullneti i popullit të Bosnjës dhe Hercegovinës nuk ishte respektuar, ata kishin kërkuar që të mbahej një referendum nën monitorim ndërkombëtar<sup>30</sup>. Qeveria boshnjake kishte premtuar mbajtjen e referendumit dhe kishte caktuar datën e mbajtjes për më 29 shkurt 1992, referendumi ishte organizuar sipas parashikimeve mirëpo ishte bojkutuar nga serbët<sup>31</sup>. Muslimanët dhe Kroatët kishin votuar në mënyrë masive në favor të pavarësisë. Në kundërpërgjigje, serbët kishin deklaruar pavarësinë nga Bosnja, i cili akt kishte dërguar në fillimin e luftimeve.

Me qëllim të uljes së tensioneve dhe luftimeve, KE kishte pranuar rezultatet e referendumit të 06 prillit 1992 dhe SHBA-të kishin njohur Slloveninë, Kroacinë dhe Bosnjën e Hercegovinën një

<sup>28</sup>Shif Opinioni 2 dhe 3 I Komisionit arbitrar mbi ish-jugosllavinë 11 janar 1992

<sup>29</sup>Musgrave, Thomas, Self Determination and National Minorities, Oxford University Press, UK, (1997), fq.- 118-119

<sup>30</sup>Rogel, Carol, The Break Up of Yugoslavia and the War in Bosnia, Greenwood Publishing Group, (1998), fq.- 128-129

<sup>31</sup>Po aty, fq.- 129

ditë më vonë<sup>32</sup>. Poashtu edhe me Maqedonin kishte probleme mirëpo kësaj radhe me fqinjun e saj Greqinë në lidhje me emrin “Maqedoni”, pasi që Greqia kishte një krahinë të quajtur “Maqedoni” dhe frikohej që shteti maqedonas do të mund të bënte pretendime territoriale në atë krahinë edhe pse komisioni i arbitrazhit kishte përfunduar që “përdorimi i emrit Maqedoni” nuk do të mund të nënkuptonte ndonjë pretendim territorial ndaj ndonjë shteti tjetër. Më pas Maqedonia ishte njohur më 08 prill 1993, në bazë të arritjes së një kompromisi me Kombet e Bashkuara me emrin “Ish Republika Federale Jugosllave e Maqedonisë” duke pritur në zgjidhjen përfundimtare të emrit<sup>33</sup>.

Në Kosovë aparati shtetëror shtypës serb kishte sjellur forca të shumta policore ushtarake, ku kishin rrahur dhe vrarë shumë shqiptare. Serbët pasi që nuk kishin marrë pëlqimin e shqiptarëve pra institucioneve të Kosovës, u kishte kërkuar të nënshkruante një dokument i cili do të legjitimonte pushtetin serb në Kosovë<sup>34</sup>. Pengesa me forcë e shtetësisë dhe sovranitetit të Kosovës si edhe rënia e RSFJ-së çoi domosdoshmërisht në manifstimet që vijojnë të ushtrimit të së drejtës për vetëvendosje nga kombi shqiptarë, të cilët hartuan Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës e bërë nga Asambleja e saj më 2 Korrik të vitit 1990. Regjimi i Beogradit kishte reaguar në mënyrë brutale ndaj këtij akti duke mbyllur parlamentin e Kosovës i cili më pastaj kishte kaluar të veproj në fshehtësi pa praninë e deputetëve serb dhe malazez. Në referendumin e organizuar nga Parlamenti i Kosovës nga 26-30 shtatori i vitit 1990, kishin marrë pjesë 87% e popullatës nga e cila 99.8% kishin votuar për pavarësi<sup>35</sup>. Më 22 dhjetor 1991, qeveria e Kosovës në ekzil, kishte dorëzuar aplikacionin për njohje ndërkombëtare të Kosovës në Konferencën Evropiane për Jugosllavinë<sup>36</sup>. Kjo përpjekje për njohje ndërkombëtare kishte dështuar, duke marrë përgjigje negative nga komuniteti ndërkombëtar, me arsyen se institucionet dhe organet paralele (qeveria në ekzil dhe presidenti i Kosovës) nuk kishin forcë që në mënyrë efektive të kontrollonin territorin dhe popullatën. Ndërkaq Qeveria e Kosovës në ekzil nuk kishte as polici dhe as armë që të veproj brenda vendit dhe jasht saj. Gjatë këtyre viteve pozita e shqiptarëve gjithnjë e më shumë rëndohej, papunësia rritej pasi që serbët i largonin shqiptarët nga vendet e punës duke i mbushur me serbë të shpërngulur në Kosovë nga Bosnja dhe Kroacia, të cilëve

---

<sup>32</sup>Po aty, 29, fq.-118-119

<sup>33</sup>Meier, Victor, Yugoslavia, A History of Its Demise, Routledge, London and New York, (1999), fq.- 94-96

<sup>34</sup>Po aty, fq.- 237

<sup>35</sup>Po aty, 30, fq.- 81

<sup>36</sup>Po aty, fq.- 237

Beogradi iu kishte ofruar kredi të mira, shtëpi dhe punë për të gjithë serbët e malazezët të cilët ishin të gatshëm të vendoseshin në Kosovë.

### **I./3.Lufta për Vetëvendosje**

Të gjendur para një situatë të rëndë si ekonomike, sociale dhe dëbimeve të ndryshme, shqiptarët e Kosovës kishin organizuar njësi ushtarake që të mbronin të drejtat e tyre me anë të forcës. Shqiptarët organizuan Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), që ishte formuar për arsye të politikave shtypëse të beogradit dhe mosgadishmërinë e komunitetit ndërkombëtar që t'iu përgjigjet lidhshimit kosovar. Paqja e Dejtonit e nënshkruar në dhjetor të vitit 1995, i kryesuar nga Riçard Holbruk që ishte në krye të delegacionit të SHBA-së, që njëherit ishte iniciatori kryesorë dhe duke insistuar që e vetmja qështje në agjendën e Dejtonit ishte zgjidhja paqësore e konfliktit në Bosnjë, Kosova duhej të priste. Duke injoruar situatën në Kosovë, paqja e Dejtonit në të vërtetë kishte forcuar pozitën e Millosheviqit në nivelin ndërkombëtar dhe të brendshëm. Ai do të shihej si njeri i paqes pasi që ai ishte njeri nga nënshkruesit e Paqes së Dejtonit dhe tani ai mund të kërkonte sovranitetin legjitimues mbi Kosovën<sup>37</sup>. Në dhjetor të vitit 1996, Bashkimi Evropian kishte shpallur qëndrimin e përbashkët për përfundimin e kufizimeve të marrëdhënieve ekonomike dhe financiare, duke neglizhuar situatën dhe shkeljet e vazhdueshme të të drejtave të njeriut që ndodhnin në Kosovë<sup>38</sup>. Lëvizja paqësore në Kosovë kurr nuk kishte pasur përkushtim serioz nga Komuniteti ndërkombëtar për zgjidhjen e problemit. Pozicioni serb, pas Paqes së Dejtonit, ishte në një vijë të komunitetit ndërkombëtar për mosndryshim të kufijve dhe me nenin 2(4) të kartës së OKB-së mbi Sovranitetin territorial. Të nxitur nga Komuniteti ndërkombëtar, ishte hapur dialogu në mes shqiptarëve dhe serbëve të Beogradit, të cilin Millosheviqi e kishte keqpërdorur për rregullimin e pozicionit të tij ndërkombëtar<sup>39</sup>. Për të fituar vëmendjen e komunitetit ndërkombëtar u deshtën shumë masakra, shpërngulje të shqiptarëve, për ndaljen e atij procesi. Krijimi i UÇK-së, kishte ardhur si rezultat i refuzimit serb për dialog dhe hezitimi i komunitetit ndërkombëtar që në mënyrë adekuate të adresoj situatën në Kosovë. UÇK-ja kishte fituar përkrahjen e popullatës shqiptare, që tani e tutje kishin kuptuar se e vetmja rrugë në fitimin

<sup>37</sup>Po aty, 3, fq.- 239

<sup>38</sup>Raporti i Komisionit të Pavarur Nderkombetar per Kosoven, The Kosovo report: conflict, international response, lessons learned, Oxford University Press, UK, (2000), fq.- 60

<sup>39</sup>Po aty, 10, fq.- 117

e të drejtave ishte qasja në luftë. Formacionet e organizuara të UÇK-së, të udhëhequra nga Komandanti legjendar Adem Jashari, i dolën përballë armikut shekullor dhe bënë luftën, sakrifikuan jetën për të mbrojtur popullin duke fituar edhe beteja të lavdishme gjatë viteve 1997, 1998 dhe 1999. Kjo rezistencë heroike ndërgjegjësoi botën dhe shtetet demokratike si dhe qendrat e vendosjes. Ndërhyri edhe diplomacia e miqve të kombit dhe atdheut. Kushtrimit iu përgjigjen të gjithë, depot e armëve iu hapen, trimat dhe armët vinin nga çdo anë, kufiri shqiptaro-shqiptar u thye, u krijuan edhe territore të lira. Serbia hakmerrej me masakra si në Llaushë, Prekaz, Gllogjan, Rogovë, Reçak dhe vende tjera të Kosovës. Ndërhyri Evropa me mision vëzhgues (KVM-portokalli) që udhëhiqej nga Ambasadori William Walker. Ambasadori dhe i mirënjohuri Riqard Hollbruk, i ngarkuari nga Presidenti Klinton për çështjet e Ballkanit, vënë kontaktet e drejtpërdrejta me UÇK-në (Junik, takimi me kom. Lumin ). Pas masakrës së Reçakut W. Walker jep kualifikimin si vepër e rëndë krimi e kryer nga forcat serbe ndaj popullsisë civile. Bota demokratike reagoi, ndërhyri edhe diplomacia, u organizua konferenca në Francë (Konferenca e Rambujesë) ku palë e bisedimeve ishin pushteti serb, Kosova përfaqësohej nga Ekipi heterogjen kosovar, intelektual, publicist dhe luftëtarë (I. Rugova, H. Thaçi, R. Qosja, J. Krasniqi, R. Buja, A. Bajrami, V. Surroi, B. Shala, B. Kosumi etj) i cili kryesohej nga Z. Hashim Thaçi, komisar politik i UÇK- së, takimi i parë dështoi sepse pala serbe nuk nënshkroi marrëveshjen, u paralajmërua vazhdimi. Pasi edhe ndërhyrja ushtarake e NATO-së (me 24 mars 1999) dhe e bashkësisë ndërkombëtare për ndaljen e gjakderdhjes së popullsisë së pafajshme dhe duarthatë si dhe të represionit shtetërorë Serb mbi shqiptarët shumicë në Kosovë. Me marrëveshjen e Kumanovës, pas 74 ditë bombardimesh nga NATO-ja ndaj forcave serbe dhe pikave strategjike në tërë serbinë, serbia dhe Millosheviqi kapitulloi, çizmjia serbe një herë e përgjithmonë iku nga Kosova për tu mos kthyer kurrë. Të shpërngulurit u kthyen në vatrat e tyre të djegura, jeta rifilloi, rindërtimi u ndihmua, por edhe plagët mbeten të hapura për të kidnapuarit nga ushtria serbe gjatë tërheqjes, ishin me mija pleq e të rijë, gra e fëmijë. Bartën me veti të gjallë e të vdekur për të humbur gjurmët e krimit. Kosova e pasur në miniera dhe minerale ka qenë gjithmonë cak i hegjemonisë serbomadhe e cila ka dashur që Kosovën ta nënshtroj dhe popullsisë së saj shumicë shqiptarëve tua humb identitetin kombëtar. Sipas propagandës serbe, Kosova është djep i kombit serb, nëse kanë harruar ndonjë djep gjëkund, duke punuar dhe shërbyer në pronat e agallarëve dhe bejlerëve, "raja" serbe atë e ka lënë pak më në veri të

Kosovës ku edhe u themelua shteti i parë serb Ras (Rashka e sotme). Kështu që Kosova sipas serbëve duhet "mbrojtur" sepse me këtë "mbrohet" hegjemonia serbomadhe.

## Kapitulli II

### II/1.VETËVENDOSJA NË PËRGJITHËSI DHE RASTI I KOSOVËS NË VEÇANTI

Parimi i vetvëndosjes së popujve paraqet një rën ndër parimet më të rëndësishme dhe themelore të së drejtës ndërkombëtare bashkëkohore. Ky parim gjenezën e ka që nga lidhja e marrëveshjes së Madridit më 1526 kur Francisi i parë i Francës ja cedoj Borgonjen Karlit të V dhe ky parim përkrahjen në praktikë e fiton në fund të shekullit XVIII, kur Franca zbaton plebishitin, si formë e shprehjes së vullnetit kolektiv të popullit dhe si kusht i domosdoshëm për transferimin e sovranitetit mbi një territor nga një shtet në shtetin tjetër (savoja, nica).<sup>40</sup>

Vetëvëndosja si shkallë më e lartë e emancipimit politik të një populli dhe shprehje e vullnetit kolektiv të tijë për të ardhmen politiko-shtetore, që është ngritur në nivelin më të lartë të parimeve univerzale ndërkombëtare politike, jo vetëm formal-juridikisht (me dokumente të shumta ndërkombëtare), por edhe praktikisht (me proceset e vetpërcaktimit të popujve në hapsirat e Evropës juglindore, qëndrore e lindore), pritej të vlente edhe për Kosovën dhe popullin e saj që padrejtësisht mbeti e okupuar nga Serbia, por kjo gjë nuk ndodhi.<sup>41</sup> Vetëvëndosja është paraparë edhe me shumë akte të rëndësishme ndërkombëtare, duke filluar që nga deklarata e pavarësisë së SHBA-së më 1776, deklarata Franceze mbi të drejtat e njeriut më 1789 dhe deklarata e të drejtave të popujve të Rusisë.

Një kontribut të rëndësishëm në formimin e këtij parimi kanë dhënë Willsoni dhe Lenini, ku edhe njihen dy konceptet; Willsonian dhe Leninian, që dallojnë nga ajo se Willsoni angazhohej për vetëvëndosje të brendshme pa të drejtë shkëputje, ndërsa Lenini angazhohej që shtetet të fitonin pavarësinë e tyre deri në shkëputje të plotë.

---

<sup>40</sup>Gruda, Prof Dr. Zejnullah, Mbrotja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut, Furkan ISM, Shkup, (2007), fq.- 147

<sup>41</sup>Stavileci, Akad. Esat, Rrugëtimet dhe labirintet e Kosovës dhe të Shqiptarëve, Litograf, Gjakovë, (2007), fq.- 45



Karta e OKB-së në nenin 1 par 2 proklamon si një ndër qëllimet kryesore të organizatës “zhvillimin e marrëdhënieve miqësore, të bazuar në respektimin e parimit të barazisë dhe të vetëvendosjes së popujve” neni 55 par 1; I obligon anëtarët e OKB-së që të marrin përgjegjësinë për administrimin e teritoreve, popujtë e të cilave nuk administrohen akoma plotësishtë vetë” të marrin parasyshë aspiratat politike të popullësisë dhe të ndihmojnë në zhvillimin e tyre progresiv të institucioneve të lira politike”, por që kjo nuk ishte e vlefshme edhe për Kosovën dhe popullin e saj, por ndodhi e kundërta dhe Kosova u dhunua në qdo aspekt nga Serbia deri gati edhe në shkallë të gjenocidit, por që nuk u kualifikua si gjenocid nga gjykata për krime lufte në ish Jugosllavi.

Ky parim pra mbi vetëvendosjen e popujve ishte paraparë edhe me rezolutën e OKB-së nr523(VI) si dhe me Aktin Final të HELSINKUT, por është me rëndësi të thuhet se edhe paktet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut më 1966 e parashohin këtë parim si; ai për të drejtat civile e politike po ashtu edhe ai për të drejtat ekonomike sociale e kulturore, ku në fillim të këtyre dy pakteve thuhet; “të gjithë popujtë kanë të drejtën e vetëvendosjes. Në bazë të kësaj të drejte ata e përcaktojnë lirisht statusin e tyre politik dhe të sigurojnë në liri zhvillimin e tyre civil, politik, ekonomik, social dhe kulturor.

Rol të rëndësishëm në vetëvendosjen e popujve ka dhënë rezoluta e vitit 1960 për dekolonizim të popujve të kolonizuara e cila njihej edhe si “Magna Carta e dekolonizimit”<sup>42</sup>. Por duhet theksuar se edhe për kundër egzistimit të të gjitha këtyre akteve ndërkombëtare, Kosova nuk e fitoj të drejtën për vetëvendosje për arsye politike e jo për arsye që nuk kishte të drejtë të përcaktonte statusin e vetë politiko-juridik.

---

<sup>42</sup>Po aty, 15 ,fq.- 156

## Kapitulli III

### III /1.SHPËRBËRJA E ISH-JUGOSLLAVIS (DISMEMBRATIO) DHE GJENDJA JURIDIKO-KUSHTETUESE E KOSOVËS

Shpërbërja e ish Jugosllavisë ka kaluar nëpër një proces të gjatë dhe të mundimshëm në dëm të popujve të Evropës juglindore e në veqanti ndaj popullit të Kosovës, por që kjo qështje është prej më të rëndësishmëve që nga përfundimi i luftës së ftoftë dhe bashkimi i popullit Gjerman dhe rënja e murit të Berlinit; ndarja e Çekisë dhe Sllovakisë dhe për të u kurorëzuar me fillimin e luftës në Kroaci, Slloveni, Bosnjë e Hercegovin dhe në fund në Kosovë. Ish Jugosllavia u krijua më 1918/1919, me të ahtuqajturën SKS (mbretërija Serbe, Kroate e Sllovene) dhe që në këtë fazë lindi edhe problemi i Kosovës. Pas luftimeve ballkanike territoret shqiptare u ndanë në mes të Greqisë, Malit të zi, Serbisë dhe shtetit të sapo krijuar të Shqipërisë (28 nëntor 1912). Kjo ndodhi në Konferencën e Ambasadorëve në Londër më 1913, ku Kosova dhe pjesa më e madhe e territoreve shqiptare mbetën të cinguar në pjesë të ndryshme.<sup>43</sup>

Kosova historikisht argumentoj se nuk i takonte Serbisë dhe kjo kishte ndodhur me mbajtjen e konferencës së Bujanit e cila u mbajt në Bujan të Gjakovës më 29 e 30 dhjetor të vitit 1943 dhe më 1 e 2 janar të vitit 1944, ku pas përfundimit të luftës së dyte botërore parashihej që përmes rezolutës së këtij kuvendi që populli i Kosovës të vendoste për atë se a dëshironte të bashkohej me shtetin amë Shqipërinë, që ishte edhe kërkesa e vetme e shqipëtarve të Kosovës, ku për këtë marrëveshje ishte garantue edhe komiteti komunistë nacional qllirmtarë, por kjo gjë nuk ndodhi dhe pasoj mbledhja e dytë e Prizrenit në dhjetor të vitit 1945, ku në këtë mbledhje të imponuar me dhunë ndaj delegatëve të kuvendit u vendos që gjoja "Kosova dhe populli i saj dëshiron që ti bashkohej Serbisë" por kjo ishte një akt i aneksimit të dhunshëm nga regjimi serbë i asaj kohe. Pas aneksimit ushtarak e policor të Kosovës nga Serbia më 1945, Kosova ishte në një gjendje të vështirë politike e juridike në veqanti dhe pas kësaj faze miratohet kushtetuta e parë e Jugosllavisë Federale më 1946<sup>44</sup>, por që gjendja e shqipëtarëve u përkeqësua duke u dëbuar masovisht nga Kosova. Amandamentet e vitit 1968, i dhan Kosovës disa nga prerogativat që

---

<sup>43</sup>Po aty, 15, fq.- 20

<sup>44</sup>Po aty, fq.- 21

qetësonin republikat ish Jugosllave, kjo u konfirmua me kushtetutën e vitit 1974. Edhe kushtetuta e vitit 1953 reflektonte idenë themelore të një federate të “kombeve të bashkuara dhe sovrane”. Megjithatë, kushtetuta përmbante një dispozitë specifike në nenin 113<sup>45</sup> i cili thoshte se garantohet “vetqeverisja e krahinës autonome të Vojvodinës dhe Kosovës (odlast) autonome të Kosovës dhe metohisë”. Kjo garanci federative, megjithatë u balancua me një fljali të ardhshme po në të njejtin nen, i cili bënë që këto (krahinat të kenë fuqi të vetëvendosjes që rrjedhin nga kushtetuta e Serbisë<sup>46</sup>. Pozita kushtetuse e Kosovës u përmirësua dukshëm pas miratimit të ligjit kushtetues më 1969 që i pasoj demonstratat studentore të vitit 1968, për të vazhduar me kushtetutën e vitit 1974. Edhe pse Kosova në bazë të kësaj kushtetute ishte pjesë konstituive e Serbisë, ajo nuk kishte të drejta të barabarta me republika tjera që ishin element konstituiv të federatës, ndërsa Kosova dhe Vojvodina ishin pjesë të Serbisë dhe kishin elemente të kuazi republikave, këtu po i cekim disa elemente; sikur të gjitha republikat edhe kuvendi i Kosovës kishte të drejtë ta bllokonte hyrjen në fuqi të ndryshimeve të kushtetutës federative edhe vendimet në federatë duhej të merrnin “mbeshtetje mbi parimet e marrëveshjes midis republikave dhe krahinave autonome”<sup>47</sup>

Kosova kishte organet e saja kryesore si; kuvendin krahinor dhe kishte të përcaktuar kufijtë e brendshëm administrativ si të gjitha republikat tjera si dhe kishte të drejtë në përfaqësim në kuvendin krahinor dhe atë të federatës në mënyrë të barabartë me republikat tjera, por kjo situatë nuk zgjati shumë dhe qështja e Kosovës që shënon edhe fillimin e shpërbërjes së ish Jugosllavisë ndodhi pas ardhjes në pushtet të Sllobodan Millosheviqit dhe në vizitën që i bëri Kosovës më 24 prill më 1987 në Fushë Kosovë që u takua me serb të shqetësuar që gjoja ishin të rrezikuar nga shqiptarët shumicë, pas kësaj ngjarje gjendja juridike e Kosovës u përkeqësua shumë dhe pasoj me suprimimin e autonomisë kushtetuse të Kosovës më 1989 në mënyrë të dhunshme nga forcat ushtarake që e rrethuan kuvendin e Kosovës. Kosova kishte insistuar se vendimi i kuvendit për suprimim të kushtetutës kurrë nuk kishte hyrë në fuqi ligjërishhtë, ngase nuk ishte botuar në gazetën zyrtare. Fillimi suprimimit të autonomisë edhe ashtu të cunguar të Kosovës ishte pa dyshim edhe fillimi i shpërbërjes së kësaj krijese artificiale siq e qunte diplomati Hollbruk, e cila ishte krijuar për qëllime të real politikës dhe ishte e dënuar që të zhdukej për po të njejtat qëllime

---

<sup>45</sup>Weller, Mark, Shtetësia e Kontestuar, Koha, Prishtinë (2009), fq.- 82

<sup>46</sup>Po aty, 23, fq

<sup>47</sup>Po aty, 20, fq.- 83

real politike që unë mendoj dhe kjo u dëshmuar me fillimin e luftrave interne brenda federatës, për të shënuar fundin e dhimbshëm të kësaj krijese e predestinuar për tu zhdukur.

## Kapitulli IV

### IV / 1.PARIMI ‘‘UTI POSIDETIS’’ DHE KOSOVA

Sëpari të sqarojmë se çka është kuptimi i këtij parimi në aspektin terminologjik, që do të thotë se; ashtu si e zotëroni (sendin apo territorin) në momentin e ndarjes ai është mbajtes i ligjshëm. Parimi ‘‘UTI POSIDETIS’’ së bashku me parimin e status quo-së teritoriale janë ndër parimet më të rëndësishme të së drejtës ndërkombëtare publike. Rëndësia e parimit ‘‘UTI POSIDETIS’’ në raport me Kosovën qëndron në atë se procesi i shpërbërjes së ish jugosllavisë dhe vetëvendosja në këtë rajon janë të ndërlidhura me këtë parim për arsye se, Konferenca Ndërkombëtare për ish Jugosllavi dhe kryetari i kësaj konference Lordi Karrington, kishte kërkuar nga ‘‘ komiteti i arbitrazhit’’, që kryesohej nga Robert Badinter, që me datën 20 nëntor 1991 për të dhënë mendime në lidhje me procesin e shpërbërjes së ish jugosllavisë dhe trashëgimit të shteteve. Lidhur me këtë qështje ‘‘Komisioni Badinter’’- për ish Jugosllavi në mendimin e tij (ekspertizë) me nr. 08 të datës 4 korrik 1992, theksonte se egzistimi i njërive përbërse të federatës, pas shpalljes së pavarësisë së tyre ka sjellë në pikëpyetje egzistimin e mëtutjeshëm të federatës, pasi që republikat dhe kufijtë e tyre janë njohur ndërkombëtarisht dhe konstaton se procesi i shpërbërjes së RSFJ është në përfundim e sipër dhe se e ashtuquajtura jugosllavi nuk egziston më. Ky vendim është ripohuar edhe në rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së me nr. 777 (1992) sipas së cilës shteti i njohur mëpar- si RSF e jugosllavisë nuk egziston më<sup>48</sup>.

Pra këtë procesë të zhbërjes së RSFJ-së, në të drejtën ndërkombëtare njihet si ‘‘Dismembratio’’. Në mendimin e tretë (3) Komisioni Badinter, identifikoi tri qështje të kufijve të ish jugosllavisë dhe atë; e para – të gjithë kufijtë e jashtëm duhet të respektohen në përputhje me kartën e OKB-së, në deklaratën mbi parimet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me marrëdhëniet miqësore dhe bashkëpunimin në mes të shteteve në përputhje me kartën e OKB-së (rezoluta 2625 (XXV) e asamblesë së përgjithshme dhe në aktin final të Helsinkit dhe në parimin që gjendet në nenin 11 të konventës së Vjenës të datës 23 Gusht 1978 mbi trashëgimin e shteteve në marrëdhëniet ndërkombëtare. E dyta – Kufijt në mes të Kroacisë dhe Serbisë, në mes të Bosnjës dhe Serbisë

---

<sup>48</sup>Gruda, Prof Dr. Zjnullah, E drejta Ndërkombëtare Publike, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, (2003), fq.- 64

dhe ndoshta edhe në mes të shteteve tjera të pavarura në afërsi (përfshirë Kosovën) nuk mund të zëvendësohen përveç se me marrëveshje të arritura në mes të palëve. E treta - Veç nëse palët pajtohen ndryshe kufijt e mëparshëm, bëhen kufij të njohur nga e drejta ndërkombëtare. Ky përfundim rrjedh edhe nga parimi i status quo-së territoriale dhe “UTI POSIDETIS JURIS”. Parimi “UTI POSIDETIS” fillimisht është aplikuar për dhënien fund qështjes së dekolonizimit në Amerikë dhe Afrikë, sot njihet si parim i përgjithshëm, që është dhënë edhe në vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, me seli në Hagë, të datës 22 dhjetor të vitit 1986 në rastin mes Burkina Faso dhe Mali ICJ( frontier dispute) reports fq 554 -556) E katërta- Sipas parimit të mirënjohur të së drejtës ndërkombëtare ndryshimi me forcë “i kufijëve egzistues nuk mund të prodhoj efekte legale”. Në rastin e Kosovës parimi “UTI POSIDETIS” nuk erdhi në aplikim për faktin se ky parim ju referohet vetëm ish republikave jugosllave si dhe “Komisioni Badinter”, që nuk u muar me qështjen e krahinave autonome si elemente konstitutive të RSFJ-së” po vetëm me republikat e saj si dhe me qështjen e kufijve në mes tyre. Kështu Kosova edhe kesaj radhe mbeti e përjashtuar nga e drejta për vetëvendosje edhe vetëpërcaktim të lirë. Kufijtë e Kosovës ishin të përcaktuar mëparë dhe të garantuar në kuadër të RSFJ- të Jugosllavisë federative të 8 njësive konstitutive sipas Kushtetutës së RSFJ-së së vitit 1974. Mirëpo kjo e drejtë as kësaj radhe nuk u shtrua drejtë as për njohjen e saj ndërkombëtare, pra këtu “Komisioni i Badinterit” pa të drejtë dhe në mënyrë selektive veprj në kundërshtim me Kushtetutën e RSFJ-së së vitit 1974 dhe të Drejtën Ndërkombëtare si dhe parimin e vetëvendosjes së popujve, duke përjashtuar në këtë proces Kosovën.<sup>49</sup>

“Komisioni Badinter”, nuk e muar parasysh egzistimin e Kosovës si element konstituiv të federatës jugosllave në aspekt të krahinës, që kishte kufijë administrativ siq kishin edhe republikat tjera. Vetëvendosja ju mohua Kosovës si nga aspekti i brendshëm por edhe nga ai i jashtëm edhe pse Kosova kishte të gjitha prerogativat për të fituar pavarësinë shtetërore siq kishin edhe republikat tjera të ish jugosllavisë, Serbia mëtonte se Kosovës nuk i takonte e drejta për vetëvendosje pasi që sipas Serbisë, Kosova kishte vendosë që më 1945 në mbledhjen e mbajtur në Prizren që gjoja në mënyrë vullnetare ti bashkohej Serbisë, por kjo gjë ishte mohuar vazhdimisht nga Kosova dhe populli i saj, por edhe Serbia thirrej në atë se e drejta për vetëvendosje konsumohej me një të përdorur, por këtë gjë e argumentojnë shumë ekspertë të së

---

<sup>49</sup>Reka, Prof. Dr. Blerim, E drejta e vetëvendosjes, dimension i ndërkombëtar i problemit të Kosovës, Studim Komparativ, Interdiskont, Shkup (1996), fq.- 94

drejtës ndërkombëtare, se e drejta për vetëvendosje është e pa konsumushme dhe se është qështje e një populli të vendos se me kënd do të bashkohej. Sa i përket parimit të quditshëm se qështja e Kosovës është qështje e brendshme e Serbisë, me të drejtë shtrohet pyetja sipas së cilës filozofi politike, fati politik i një populli është qështje e brendshme e një populli tjetër dhe shtetit të tij?<sup>50</sup> Dhe kjo për mendjen e arsyes së pastër mendoj që është një non sens dhe ishte absurdi më i madh që ka ndodhur ndonjë herë gjatë fitimit të pavarësisë nga vendet e ndryshme, gjë që i'u mohua Kosovës edhe pse historikisht Kosova kishte popullin, kulturën e ndryshme, territorin e përcaktuar brenda federatës si dhe të gjitha organet kryesore për të qenë shtet dhe për të qenë e barabartë me republikat tjera. Nëse i referohemi edhe një herë parimit “UTI POSIDETIS” (ashtu siq e zotëron ai është mbajtës i ligjshëm) do të vijm në përfundim se Kosova edhe pse në aspektin de jure ishte pjesë e Serbisë, në kuptimin praktik dhe de fakto Serbia kurr nuk arriti që të ketë kontroll efektiv të pushtetit mbi territorin e Kosovës dhe kjo është edhe njëra prej kritereve që kërkohet me konventen e Montevideos për kriteret për njohjen e shteteve e vitit 1933, që parasheh edhe shtrirjen dhe ushtrimin e pushtetit mbi territore dhe ndaj popullit të caktuar, që praktikisht Serbia e kishte humbur ndaj Kosovës dhe përfundimisht nëse elementet përbërëse të një krijese shtetërore nuk funksionojn, nuk mund të egzistoj edhe federatë në këtë rast ish Jugosllavija.

---

<sup>50</sup>Po aty, 16, fq.- 61

## Kapitulli V

### V / 1.VETËVENDOSJA DHE QËSHTJA E SHKËPUTJES (SECESIONIT)

Rasti i Kosovës është një rast i mirë në arenën ndërkombëtare dhe paraqet fillimin e një rendi të ri kushtetues ndërkombëtar dhe paraqet një burim të rendit të ri ndërkombëtar, e jo të shuarjes së tij. Në vend se të mbështetej në burime të tejkaluara, siq ishin mosndërhyrja dhe qështjet një dimensionale të sovranitetit, Kosova paralajmëron një sistem kushtetues ndërkombëtar postmodern që është ende në proces të themelimit të vet<sup>51</sup>. Kosova tregoj se shtetet nuk mund të thirren në të drejta dhe privilegje të tij dhe popullit të vet dhe nuk mund të thirren në doktrinen mosndërhyrjes në sovranitetin shtetëror nëse kemi të bëjmë me raste të rënda kur krijesa shtetore që ishte artificial, sillet në mënyrë agresive ndaj përbërësit të vet, në këtë rast Serbia ndaj Kosovës, deri në spastrimin etnik dhe në shkallë gjenocidi. Edhe pse qështja e Kosovës u komplikua për shkak të qështjes së shkëputjes së njëanshme, prap se prap paraqet një rast të mirë që tregon se egzistimi i parimit së paku juridikisht që egziston se shtetet nuk mund të shkëputen njëanshëm nga struktura, rasti i Kosovës ka tendenca që të bëjë përjashtim nga ky parim ndërkombëtar gjë që po dëshmohet me pavarësinë e mbikqyrur të Kosovës e cila ishte në dëm të serbisë.

Gjatë shek. 20, shumë shtete të reja janë krijuar si rezultat i lëvizjeve secesioniste dhe luftrave, të cilat erdhën menjëherë pas dekolonizimit të botës dhe rënies së perandorive komuniste. Pas Luftës së Ftohtë, kur u venit sfera e ndikimit të Fuqive të Mëdha, secesioni ishte një ndodhi e shpeshtë. Ndonëse kjo metodë e zgjidhjes së konfliktit bartë rrezikun e dhunës dhe krijimit të problemeve të reja, kjo është vërtetuar si efektive në përfundim të konflikteve etnike. Secesioni ka qenë veqanërisht i sukseshëm në shtetet multi-etnike ku ajo ka lejuar dhe mundësuar ndarjen e këtyre grupeve etnike që nuk kanë dashur më tutje bashkësi të përbashkët shtetërore. Njerzit kanë synuar secesion për arsye të ndryshme: si një reagim ndaj diskriminimit dhe poshtërimit etnik, por gjithashtu edhe si mbrojtje për kulturën e tyre nga asimilimi. Shkaku tjetër për secesion është edhe arsyeja pragmatike e lirisë politike dhe ekonomike, por gjithashtu edhe dëshira e elitave për politika të ndryshme publike, prestigj dhe pushtet. Arsyeja e fundit dhe më

---

<sup>51</sup>Weller, Mark, Shtetësia e Kontestuar, Koha, Prishtinë (2009),



kryesorja për ndarje është fakti se nuk është e lehtë të arrihet kompromisi mbi qështjet që kanë të bëjnë me etnicitetin dhe identitetin: me fjalë të tjera identiteti nacional, gjuha, vendi dhe kultura nuk janë të lehta për marrëveshje<sup>52</sup>. Secesioni kurr nuk është konsideruar si një mënyrë e përfundimit të konfliktit të Kosovës nga ana e elitave shtetërore serbe. Kjo ka qenë në kundërshtim me shumicën shqiptare në këtë vend, për të cilët secisioni ishte dhe mbeti opsioni i vetëm, gjithnjë e më shumë i fuqishëm në kontekstin e shpërbërjes së sistemit politik jugosllav në shek. 20.

Secisioni mbi bazën e vetëvendosjes është paraqitur gjatë Luftës së Dytë Botërore edhe pse prirje dhe perpjekje të këtilla kanë ekzistuar që nga okupimi i Kosovës në vitet 1912-1913. Secisioni kthehet në një opsion përsëri në vitet e 1990-ta, kur Jugosllavia u dezintegrua. Atëherë, institucionet legjitime të Krahinës Autonome të Kosovës provuan që ta ushtrojnë të drejtën për vetëvendosje. Në fakt, që nga vitet e 1960-ta, disa grupe marksiste kanë kërkuar secisionin, siq ishte: "Lëvizja Revolucionare për Bashkim Kombëtar Shqiptarë" e Adem Demaçit, e sidomos pas vdekjes së Titos në vitin 1980. Në fillim të viteve të 1990-ta, secisioni i Kosovës nga Jugosllavia dhe ngritja e saj në statusin e republikës, u konsiderua si i vetmi skenar për ta përfunduar konfliktin e Kosovës të krijuar në këtë kohë. Kjo nuk ishte marrë parasysh nga autoritetet jugosllave, me arsyetimin se të drejtë për vetëvendosje kishin republikat dhe kombet që ndërtuan shtetin federativ jugosllav. Sidoqoftë, kërkesa më e fuqishme për ushtrimin e të drejtës për vetëvendosje ishte lindja e UÇK-së në vitin 1992, si një lëvizje qytetare çlirimtare dhe lufta e saj për pavarësinë e Kosovës në vitet 1998/1999<sup>53</sup>.

E drejta e ushtrimit të secisionit kishte ndodhur edhe në rajone tjera të botës dhe këto raste janë; Sahara perëndimore, Biafra, Katanga, Timori Lindor, Tibeti, Qiproja, Bangladeshi, Eritreja, që këto raste kanë ngjashmëri dhe dallimet e tyre me rastin e Kosovës. Nëse e krahasojm Kosovën me këto raste del se Kosova kishte të gjitha elementet për të ushtruar të drejtën e shkëputjes nga Serbia e cila pa të drejtë e kishte aneksuar më 1945, por qështja e Kosovës u zvarrit me dekada për mosnjohjen e Kosovës si shtet që janë arsye të sigurisë prapa vendimeve për mosnjohjen e

---

<sup>52</sup>Hoxhaj, Dr.Enver, Politika Etnike dhe Shtetndërtimi i Kosovës, Dukagjini, Pejë, (2008), fq.- 153

<sup>53</sup>Po aty, fq.- 158

Kosovës, por edhe stabiliteti rajonal e më gjërë peshojn shumë në qështjet e njohjes së shteteve të reja dhe ky është fakt i njohur që u dëshmuua në rastin e Kosovës<sup>54</sup>.

---

<sup>54</sup>Bytyqi, Dr.Enver, E Drejta e Vetëvendosjës, Rasti i Kosovës, Prishtinë (2007), fq.- 230

## Kapitulli VI

### KONKLUZION

Vetëvendosja, për shtetet në krijim ishte qelësi i hapjes së derës për hyrje në klubin e atyre shteteve të privileguara. Për shtetet ekzistuese, e drejta për vetëvendosje ishte qelës për mbylljen e derës kundër rezultateve të padëshiruara brenda dhe jashtë tyre<sup>55</sup>. Dinamika ishte shumë e thjeshtë: e drejta për vetëvendosje ishte atraktive derisa zbatohet nga larg, ndërsa jo atraktive kur duhet zbatuar nga ana e tyre.

Rasti i Kosovës është ngusht i lidhur me shpërbërjen e ish Jugosllavis dhe gjenezën e ka që nga viti 1918 me krijimin e Mbretërisë SKS, për të përfunduar me shpërbërjen e saj me 1992. Fundi i luftës së dytë botërore shënon një fazë të re për shqiptarët dhe Kosovën dhe në këtë fazë shqiptarëve të Kosovës ju mohua një autonomi e plotë politike e territoriale për të vazhduar me masa represive kundër tyre në mënyra të ndryshme. Vitet e 60-ta ishin të vështira për Kosovën dhe si pasojë erdhi deri te eskalimi i situatës përmes demonstratave studentore të vitit 1968, pas kësaj miratohet Ligji Kushtetues 1969 për të vazhduar me Kushtetutën e vitit 1971 dhe të vitit 1974 që shënon një fazë të re juridiko-politike për Kosovën. Avansimi i autonomisë kushtetuese të Kosovës e pengoi Serbinë dhe pas kësaj periudhe filluan përgaditjet për suprimimin e autonomisë së saj deri më 1989 përfundimisht. Jugosllavia filloi të shkatërrohet dhe për këtë ishte thirrur konferenca ndërkombëtare për ish jugosllavi dhe ishte formuar arbitrazhi përmes komisionit Badinter. Badinteri kishte bërë konstatimin e gjendjes faktike dhe juridike duke marrë për bazë parimin e ashtuquajtur “UTI POSIDETIS IURIS”, por që kishte vepruar në mënyrë selektive me Kosovën. Kosova filloi luftën për Pavarësi pasi që në Dejton nuk ishte përfillur kërkesa që Kosova të jetë pjesë e agjendës dhe kjo luftë la pasojë të rënda për Kosovën, për tu kurorëzuar me luftën e UÇK-së për çlirim dhe me hyrjen e Nato-së ndaj Serbisë duke shkelur sovranitetin e Serbisë në emër të ndërhyrjes së shkeljes së rëndë të së drejtës humanitare ndërkombëtare. Kosova paraqet një rast të veçantë në vetëvendosje si dhe e ashtuquajtura vetëvendosje zhdëmtuese që i atribuohet Kosovës në luftën e gjatë për pavarësi kjo doktrinë ka dy variante;

---

<sup>55</sup>Po aty, 6, fq.- 32

mungesa e përfaqësimit nga njëra anë dhe represioni dhe agresioni që ju bënë Kosovës nga ana tjetër. Padyshim se rasti i Kosovës paraqet elemente të veqanta sa i përket të drejtës së vetëvendosjes dhe krijimit të shteteve të reja dhe padyshim quhet Sui Generis (I llojit të veqantë) që më të veqantë e bën rastin inkorporimi i faktorit ndërkombëtar duke angazhuar akterët kryesor ndërkombëtar për zgjidhjen e këtij problemi.

Problemi i qështjes së Kosovës që prej vitit 1918 e deri në luftën e saj për vetëvendosje me 1998/1999, sipas autoreve të ndryshëm argumentohet në tri pika tejet të rëndësishme:

Pika e parë, lidhet me padrejtsitë në ndarjen e territorit gjatë etapave historike nga regjimi jugosllav, ku në këtë punim kemi argumentuar raste të ndryshme të ndarjes së territorit shqiptarë.

Pika e dytë, ka të bëjë me shkatërrimin e vendit dhe shpërbërjen e saj, ku zyrtarët serbë madje kishin paraqitur opzione të ndarjes së territorit të Kosovës në rast të pavarësisë së saj, ashtu që pjesa e veriut do të bashkohej me serbi.

Pika e tretë dhe më e rëndësishme, e përkrahur edhe nga ndërkombëtarët është e drejta për vetëvendosje për popujt e viktimizuar. Serbët në mënyrë të qëndrueshme kishin shkelur të drejtat themelore të njeriut ndaj shqiptarëve të Kosovës, duke përdorur programe të përgatitura nga autoritetet serbe siq ishte programi famëkeq “Necertania” i rishikuar e ndryshuar gjatë jugosllavisë së parë dhe dytë, për të arritur qëllimin e saj kulminante gjatë luftimeve të viteve 1998/1999 me vrasjen e më shumë se 13 000 mijë shqiptarëve. Dhuna serbe ndaj shqiptarëve kishte treguar qëllim të qartë që ti eliminonin nga Kosova.

Në përfundim, është e qartë se Kosova pas shpalljes së pavarësisë, ku krijoi institucione demokratike, është e aftë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në mënyrë të vecantë të të drejtave të minoriteteve. Në këtë mënyrë Kosova po demonstroi pjekurin e saj, me atë të popujve të civilizuar, duke ju dhënë shembull regjionit për mbrojtje të të drejtave të njeriut, pa diskriminim etnik, fetar, gjuhësor dhe kulturor.

## **LITERATURA E KONSULTUAR:**

BYTYQI, Enver: “E drejta e vetëvendosjes rasti i Kosovës”, Prishinë, 2007

BENNETT, Christopher: “Yugoslavia’s Bloody Collapse: Causes, Course And Consequences”, C.Hurst&Co.Publishers, London, 1995

GRUDA, Prof.Dr. Zejnullah “Mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut”, Furkan ISM, Shkup, 2007

GRUDA, Prof.Dr. Zejnullah “E drejta ndërkombëtare publike”, Universiteti i Prishinës, Prishinë, 2003

HASANI, Prof.Dr. Enver: “ Shpërbërja e ish Jugosllavisë dhe Kosova”,Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare, Tiranë, 2000

HASANI, Prof.Dr. Enver: “Mendimet e komisionit BADINTER për ish Jugosllavi”, Rominor, Prishinë, 2006

HOXHAI, Prof.Dr. Enver: “Politika Etnike dhe Shtetndërtimi i Kosovës”, Dukagjini, Pejë,2008

HANUM, Hurst: “Autonomy, Sovereignty, And Self-Determination: The Accommodation of Conflicting Rights”, University of Pennsylvania Press, USA, 1996

JUDAH, Tim: “Kosovo, War and Revenge”, Yale University, Bolton, 2002

MALCOM , Dr.Noel: “Kosova: Një Histori e Shkurtër”, Koha, Prishtinë, 2001

MARRIOT, A.R. John: “The Eastern Question: An Historical Study In European Diplomacy”, Clarendon Press, Oxford, 1917

MUSGRAVE, Thomas: “Self Determination and National Minorities”, Oxford University Press, UK,1997

MEIER, Victor: “Yugoslavia, A History of Its Demise, Routledge”, Routledge, London and New York, 1999

REKA, Dr.Blerim: ‘‘E drejta e vetëvendosjes, dimesioni ndërkombëtar i problemit të Kosovës’’, Interdiskont, Shkup, 1996

REXHA, Dr.Iljaz: ‘‘Lidhja e prizrenit në Dokumentet Osmane’’, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 1978

REPISHTI, Sami: ‘‘Rezoluta e Bujanit 2 janar 1944, Një analizë, studime historike’’, 1995

RAMET, Sabrina P: ‘‘Views from Inside, Memoirs Concerning the Yugoslav Breakup and War, Slavic Review’’, Cambridge University Press, UK, 2000

Raporti i Komisionit të Pavarur Ndërkombëtar për Kosovën ‘‘The Kosovo report: conflict, international response, lessons learned’’, Oxford University Press, UK, 2000

ROGEL, Carol: ‘‘The Break Up of Yugoslavia and the War in Bosnia’’, Greenwood Publishing Group, USA, 1998

STAVILECI, Akademik Esat: ‘‘Rrugëtimet dhe labirintet e Kosovës dhe të shqiptarëve’’, Litograf, Gjakovë, 2009,

WELER, Mark: ‘‘Shtetësia e kontestuarë ‘’, Koha, Prishtinë, 2009

WOODWARD, Susan I: ‘‘Balkan Tragedy: Chaos And Dissolution After The Cold War’’, Brookings Institution Press, Washington D.C, 1995